

NË GURIN ROSETA (ROSETA STONE) ËSHTË SHKRUAR GJUHA E LASHTË MAQEDONE/SHQIPE



Dr.Luftulla Peza - Dr.Liljana Peza

Pllaka “Guri i Rosetës” (i njohur në botë si Roseta Stone) është një pllakë shkëmbi i llojit granodiorit ngjyrë të zeze, shkëmb vullkanik intruziv, i afërt me granitin. Pllaka Roseta është e njohur për mbishkrimin e famshëm, që përmban. Pikërisht për të parë nga afër Gurin e Rosetës gjatë janarit 2019, vizituam bashkë me fëmijët tanë Evën dhe Sindin Muzeun Britanik në Londër.


Përmasat e pllakës janë 112x75x28 cm. dhe shkrimi mendohet se është gërvishur mbi pllakë në vitin 196 p.e.s. Guri i Rozetës është gjetur në vitin 1799, nga një ushtar francez, gjatë ekspeditës së Napoleon Bonapartit në Egjipt. Sipas një marrëveshje, që kishte midis forcave franceze dhe angleze, që ishin në atë kohë në Egjipt, Guri i Rosetës u muarr nga anglezët dhe sot ndodhet në Muzeumin Britanik në Londër, që nga viti 1802. Në këtë muze Guri i Rosetës përbën një nga objektet më të kërkuara të vizitorëve. Qeveria Egjiptiane vazhdon ta quaj të vjedhur Gurin e Rozetës dhe vazhdon të kërkojë kthimin e tij në vendin e origjinës, në Egjipt.

Guri Roseta nuk është gjetur në vendin e tij fillestar, në faltoren, ku ishte vendosur. Ai është gjetur i hedhur në një grumbull, ndërmjet gurëve të ndërtimin në një vend tjetër, në rrjedhën e poshtme të lumit Nil, ku u gjet rastësisht nga ushtari francez.

Në Gurin Roseta është gërvishur një njoftim i gjatë në tre lloje shkrimi dhe gjuhe, të përdorur në rajonin Memfis të Egjiptit në vitin 196 p.e.s., gjatë dinastisë maqedone të Ptolemeve dhe që i përkiste mbretit Ptolemeu i V.

Pas vdekjes së Aleksandrit të Madh (323 p. e.s.), perandoria e tij e madhe maqedone, që shtrihej nga Maqedonia deri në Indi, u nda midis gjeneralëve të tij. Ndër to Ptolemeu mori nën sundim Egjiptin dhe formoi atje mbretërinë e Ptolemeve. Dinastia maqedone e Ptolemeve vazhdoi të qeverisë Egjiptin gjatë 275 vjetëve, nga viti 305 deri në vitin 30 p.e.s. Vetë Ptolemeu ka qenë gjeneral maqedonas, ku gjuha maqedone ka qenë shkruar dhe vitet e fundit është vërtetuar, që ka qenë një dialekt i gjuhës së lashtë pellazge, shumë e afërt me gjuhën e sotme shqipe. Kjo është vërtetuar vitet e fundit me deshifrimin e mbishkrimeve në gjuhën maqedone të lashtë nga prof. Shaban Berisha nga Kosova, i cili për këtë çështje ka botuar një artikull në portalin Pashtriku (2017).

Guri i Rosetës është i thyer, por në figurën më poshtë ai është i rindërtuar afërsisht ashtu siç ka qenë. Teksti i shkruar në gur është një dekret mbi mbretin Ptoleme i V (204-181 p.e.s.) dhe është shkruar në tri forma shkrimi dhe gjuhe.



Në pjesën e sipërme të gurit është përdorur shkrimi me hieroglifet egjiptiane, lloj shkrimi në Egjiptin e lashtë, ku vizatimet shërbejnë si shenja për fjalët. Lajmi i shkruar në gurë bën të qartë se priftërinjtë e faltores në Memfis, mbështesin mbretin Ptoleme në punën e tyre.

Në pjesën e mesme të gurit (shih figurën) është po ky tekst, por i shkruar me alfabetin demotik, ose gjuha e përdorur nga populli në atë kohë, një lloj shkrimi i përdorur në Egjipt pasi dolën nga përdorimi hieroglifet egjiptiane. Shkrimi demotik është përdorur në Egjipt nga viti 450 p.e.s. deri në vitin 450 të erës sonë, kur u zëvendësua me shkrimin koptik.

Në pjesën e poshtme, që do ta shohim më poshtë, ndodhet shkrimi i tekstit në gjuhën maqedone të vjetër, për të cilin deri tani mendohet se i përket gjuhës greke.


LEXIMI I SHKRIMIT TË GURIT TË ROSETËS

Shkrimi në Gurin Roseta mendohet se është një dekret mbi mbretin Ptoleme i V të Egjiptit (204-181 p.e.s.), i gërvishur në vitin 196 p.e.s. Guri ka rëndësi të madhe për shkencën, sepse është shkruar në tri gjuhë dhe me shkrime të ndryshme. Në gurin Roseta 14 rreshtat e sipër janë gërvishur me hieroglifet egjiptiane, paraqitur më poshtë, gërvishur

nga e majta në të djathtë. Në qendër ndodhet emri i Ptolemeut me hieroglifet egjiptiane.



Në pjesën e mesme të gurit janë 32 rreshta në gjuhën demotike:



Nuk jemi në gjendje të flasim mbi këtë gjuhë, atë duhet ta shohin specialistë, sepse ashtu si gjuha dhe shkrimi koptik, vërtetuar vitet e fundit që është një formë e lashtë e gjuhës shqipe edhe gjuha dhe shkrimi demotik duhet të kenë të njëjtën afërsi.

DESHIFRIMI I TEKSTIT

Me deshifrimin e tekstit të Gurit të Rosetës u morën disa studiuës. Studiuësi francez J. F. Champollion (1790-1832) në tekstin me hieroglifet egjiptiane arriti të lexojë emrin e Ptolemeut dhe nga kjo dha një version të përafërt të gjithë tekstit të gërvishur me hieroglife.

Filologu shqiptaro-italian Xhuzep Katapano ne librin e tij” Thoti fliste Shqip” studioi Qytetërimin e Lashtë Egjiptian. Sipas tij ky qytetërim e ka zanafillën në Atlantidë, ku ka qenë zhvilluar qytetërimi më i lashtë, që përmendet nga autorët antikë dhe pasi ishulli u përmyt, njerzit kaluan në Egjipt dhe formuan atje Qytetërimin Egjiptian. Për këtë problem mund të lexoni librin “Atlantida” të Skender Hushit.

Në Egjipt Thoti, perëndia e arsimit dhe diturisë në Egjiptin e lashtë, Katapano shkruan që i ka përpiluar hieroglifet egjiptiane, alfabetin fonetik të egjiptianëve të lashtë, i mbështetur në gjuhën e vet amtare – në gjuhën shqipe. Katapano formuloi edhe një listë të gjatë me hieroglifet egjiptiane, të cilave ju jep emërtimet në bazë të fjalëve të gjuhës shqipe. Në këtë mënyrë Katapano ka zbuluar një gjë mjaft të rëndësishme, për të lexuar hieroglifet egjiptiane, plotësisht të besueshme, bazuar në nivelin e diturive të sotme.


Arritjet e Katapanos për spjegimin e hieroglifëve egjiptiane me anë të gjuhës shqipe janë shumë të rëndësishme për shkencën dhe historinë e gjuhës shqipe, por fatkeqësisht ende asnjë studiuës shqiptarë nuk e tërhoqi problemi, për ta studiuar më tutje.

Shkrimi koptik, një lloj shkrimi i përdorur në Egjipt para se atje të vijnë arabët, vitet e fundit është vërtetuar që i përket gjuhës së lashtë pellazge/shqipe. Sudiuesja Fiorina Shiko e paraqiti studimin e saj në Simpoziumin e katërt të Qendrës së Studimeve Pellazgjike “10 mijë vjet nga Zanafilla e Shqiptarëve (Tiranë. 2016) “Ati Ynë , në gjuhën kopte, përkthyer nga gjuha shqipe“.

PJESA E POSHTME E SHKRIMIT

Në pjesën e poshtme të Gurit të Rosetës është po ai tekst, që ndodhet në dy pjesët e mësipërme, por i shkruar me gërmat e alfabetit pellazg, por në gjuhën e lashtë maqedone, që në këtë kohë ka qenë gjuha e administratës, gjuha e drejtuesve të Egjiptit, që kanë qenë maqedonas. Kjo për ne është edhe pjesa më interesante, që na shtyri të ndërmarrim këtë studim të Gurit të Rosetës.

Ky është po ai alfabet, që është përdorur për të shkruar Iliasit e Omerit, mbishkrimet maqedone të vjetra dhe shumë dokumente të lashta ilire, thrake etj., me të cilat kemi punuar mjaft vite.



Në këtë tekst shihet që disa here është shkruar emiri Ptoleme – ΠΤΟΛΕΜΑΙΟΣ

Në enciklopedinë Wikipedia, nga kemi marrë disa të dhëna për këtë artikull, shkruhet sikur pjesa e poshtme e tekstit të Gurit të Rosetës është në “gjuhën e vjetër greke”. Ky është mendimi i shprehur deri më sot nga dijetarët. Kjo nuk është e vërtetë, po ti referohemi historisë dhe përmbajtjes së vetë shkrimit. Aleksandri i Madh i Maqedonisë dhe gjeneralët e tij kanë jetuar afër 250 vjet para se grekët të përmenden për herë të parë në histori. Fisi grek i pa organizuar dhe pa kulturë përmendet për herë të parë në Ballkan pas pushtimit romak, d.m.th., gjatë shekullit të parë p.e.s. Por romakët e pushtuan Ballkanin në vitin 168 p.e.s., pas lufrash të ashpra rreth 200 vjeçare me mbretëritë e ilirëve, maqedonëve, epirotëve, thrakëve etj., që kanë folur dialekte të ndryshme, të ardhur nga gjuha e përbashkët dhe më e lashtë pellazge. Pra

maqedonët dhe popujt si vëllezër të tyre ilirët, epirotët, thrakët etj. i kishin ngritur mbretëritë e tyre në Ballkan, kur grekët ende nuk njiheshin në histori.

Nga ana tjetër këta popuj të gjithë e kanë zotëruar shkrimin dhe kanë lënë dokumente të shkruara të gjuhës së tyre. Për këto arsye pjesa e poshtëme e shkrimit në Gurin Roseta nuk mund të jetë në gjuhën greke, por në gjuhën që ka folur e shkruar Aleksandri i Madh dhe Ptolemeu dhe kjo është gjuha maqedone e lashtë.

Për ta vërtetuar këtë le ta shohim tekstin e shkruar nga afër, në rrjeshtat e mëposhtëm, ku paraqiten rrjeshtat e shkrimit ashtu siç janë të ruajtura në Gurin e Rosetë (fig. 2).



Fig. 2-

Ky është teksti në gjuhën maqedone i Gurit të Rozetës. Guri është i thyer, prandaj Richard Porson (1803) ka bërë plotësimet e munguar në tekst. Nga teksti kemi zgjedhur rrjeshtat, ku mendojmë se teksti është më i qartë dhe mund të bëjmë ndonjë shpjegim të përmbajtjes së tij.

ΤΩΝΕΙΣ = ΤΟΝ...

ΙΔΟΜΕΝΩΝ-----32 IDOMENΩΝ = IDOMENON. emër personi

ΕΚΑΙ ΑΡΓΥΡΙ-----33 ΑΙΑΡΓΥΡΙ = ΑΙ ΑΡΓΙΡΙ, ΑΡΓΙΡΙ, emër personi

ΟΥΣΙΝΕΙΣΤΟ-----34

ΑΡΑ ΠΑΝΤΑ-----35 ΑΠΑΝΤΑ = Α ΡΑ Ν' ΤΑ = ΑΣΗΤ ΡΑ ΝΕ ΤΑ

ΙΜΙΑΤΕΛΕΙΝ = ΑΤΙ ΙΜ ΛΕΥ

ΡΕΤΩΝΚΑΙΤΑ-----37 ΕΤΩΝΚΑΙΤΑ = Ε ΤΟΝ ΚΑΙ ΤΑ = ΤΕ ΓΛΙΘΗ QAJN ΑΤΕ

ΕΣΤΑΤΩΙΟΜΩΙ

ΝΑΥΤΟΝ ΕΠΙΧΩΡΙΟΙΣ 39 È [] ΑΕΕΟΡΤΑΙΕΚΑΙΠΑ

ΧΥΛΟΥΝΕΝΕΚΑΧΤΟΥΤΩΝ 41

ΕΥΚΑΡΙΣΤΟΥΝΑΟΝΣΥΝΕ 42

ΙΣΚΑΘΑΙΕΡΚΑΙΕΠΙΠΑΣΩΝ 43

ΜΦΕΙΑΗΤΕΙΟΝΟΠΩΣΣΥΝ 44

ΙΣΚΑΘΑΙΕΡΚΑΙΕΠΙΠΑΣΩΝ 43

ΧΡΥΣΑΕΝΘΙΣΓΕΓΡΑΨΕΤΑΙ ΔΙΟ 45 DIO

ΚΑΙ ΤΗΝ (ἀείνει ὁ μὲν καὶ 4 ἡμέρας) 46

ΡΤΗΝΚΑΙΠΑΝΗΓΥΡΙΩ ΕΝΤΟΙΣΚΑΤΑΙ 47

[]

ΝΙΑΥΤΟΝ ΚΑΤΑ ΤΗΝ ΤΕ ΑΝΘ ΚΑΙ ΤΗΝ ΚΑΤΩ 49 = ΑΥ ΤΟΝ ΚΑΤΑ ΤΗΝ ΤΕ ΑΝ Ο ΚΑΙ ΤΗΝ ΚΑΤΟ = ΑΙ ΤΑΝ ΚΕΤΑ ΤΗΕ ΤΕ ΑΝ ΟΣΗΤ QAN ΤΗΕ ΚΑΤΑ

ΕΥΕΙΝΔΕ ΤΟΥΣ ΙΕΡΕΙΣ ΤΟΥ ΤΕ ΑΙΩΝΟ ΒΙΟΥ 50

ΥΣ ΔΕ ΙΓΜΑΤΙΣ ΜΟΥΣ ΤΟΥΣ ΑΝΗΚΟΝΤΑΣ ΕΙΣ ΤΗΣ 51

ΛΟΥΝΤΑΣ ΤΑ ΠΡΟΣΗΚΟΝΤΑ ΝΟΜΙΜΑ ΕΝΤΑΙΣ ΕΟΡΤΑΙΣ 52

ΕΣΤΙΝ ΤΟ ΔΕ ΨΗΦΙΣΜΑ ΤΟΥΤΟ ΑΝΑΓΡΑΨΑΙ ΕΙΣ ΤΗΝ ΑΜΗΝ ΜΕΛ 53

ΩΥΘΕΩΝΙΕΡΩΙ 64

THEONIEROI= THE O NIE ROI =THE OSHT NUK RON

Ky është teksti në gjuhën maqedone të vjetër në pllakën Roseta Stone, ku vejmë re mjaft fjalë të gjuhës së lashtë maqedone, të shkruara me alfabetin maqedonas dhe që janë njëllor me fjalët e gjuhës shqipe. Ptolemeu, që themeloi dinastinë e tij në Egjipt, ka qenë gjeneral i Aleksandrit të Madh dhe sigurisht ka folur dhe shkruar gjuhën e vet maqedone.

Po i japim sipas rrjeshtave:

Rrjeshti 31: ΤΩΝΕΙΕ = ΤΩΝ ΕΙΕ = ΤΟΝ ..

32: ΙΔΟΜΕΝΩΝ = ΙΔΟΜΕΝΟΝ. emër personi

“ 33: ΑΙΑΡΓΥΡΙ = ΑΙ ΑΡΓΙΡΙ, ΑΡΓΙΡΙ, emër personi,

“ 35: ΑΠΑΝΤΑ = Α ΡΑ Ν’ ΤΑ = ΑΣΗΤ ΡΑ ΝΕ ΤΑ,

“ 36: ΙΜΙΑΤΕΛΕΙΝ = ΙΜΙ ΑΤΕ ΛΕΙΝ = ΑΤΙ ΙΜ ΛΕΥ

“ 37: ΕΤΩΝΚΑΙΤΑ = Ε ΤΟΝ ΚΑΙ ΤΑ = ΤΕ ΓΙΤΗΕ QAJN ΑΤΕ,

“ 39: ΑΤΟΝΕΠΙΧΩ ΡΙΟΝ = ΑΤΟ ΝΕΡΙ ...

“ 49: ΑΥ ΤΟΝ ΚΑΤΑ ΤΗΝ ΤΕ ΑΝ Ο ΚΑΙ ΤΗΝ ΚΑΤΟ = ΑΙ ΤΑΝ ΚΕΤΑ ΤΗΕ ΤΕ ΑΝ ΟΣΗΤ QAN ΤΗΕ ΚΑΤΟ,

Nga ky vështrim i shkurtër i tekstit të pjesës së poshtme të pllakës Roseta Stone, vejmë re se ajo përmban fjalë të gjuhës maqedone të lashtë, që është folur në Maqedoni dhe më pas në Egjipt, kur aty u vendos dinastia e gjeneralit maqedonas Ptolemeu. Nga ana tjetër vihet re, që fjalët e kësaj gjuhe të lashtë maqedone, që ndodhen në këtë tekst, përputhen plotësisht me fjalët e gjuhës shqipe. Me një punë më të gjatë dhe më të kujdesshme në këtë tekst mund të gjinden edhe fjalë dhe shprehje të tjera të afërta me gjuhën e sotme shqipe.

Fjalët dhe shprehjet maqedone, që përputhen me ato të gjuhës shqipe janë:

TON = tan, të gjitha, ΑΠΑΝΤΑ =asht pa n ta, ΙΜΙΑΤΕΛΕΙΝ = ati im leu, ΕΤΩΝΚΑΙΤΑ = të gjithë qajn ate, ΔΙΟ (Zeusi), ΑΥ ΤΟΝ ΚΑΤΑ ΤΗΝ ΤΕ ΑΝ Ο ΚΑΙ ΤΗΝ ΚΑΤΟ = ΑΥ ΤΟΝ ΚΑΤΑ ΤΗΝ ΤΕ ΑΝ Ο ΚΑΙ ΤΗΝ ΚΑΤΟ = ai tan këta the te an osht qan the keta si dhe emra personash ΙΔΟΜΕΝΟΝ, ΑΡΓΙΡΙ (ΑΡΓΙΡΙ) etj.

Kjo është hera e parë që në Gurin e Rozetës vihet re gjuha maqedone e lashtë, me alfabetin maqedonas, një variant me origjinë nga alfabeti i lashtë pellazg. Deri tashti gjithkund është shkruar, që teksti në pjesën e poshtme të këti guri me famë është në gjuhën greke të lashtë me alfabetin grek.

Në këtë mënyrë gjuhës shqipe i shtohet edhe një dokument tjetër mjaft i rëndësishëm, Guri i Rosetës, i shkruar në vitin 196 p.e.s.

Golem-Pragë, 24 maj 2019